

Sabile KEÇMEZI-BASHA

Qëndresa e grave të familjes Jashari, 1998

Çlirimi i Kosovës është vepër e disa brezave të popullit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar, ndërsa heroizmi i gruas shqiptare është i njohur ndër shekuj.¹Pra, sipas burimeve historike, qëndresa dhe sakrificat e gruas shqiptare, si formë e rezistencës së saj, dëshmojnë si vazhdimësi.²Megjithatë, pjesëmarrja e gruas në jetën shoqërore në Kosovë në përgjithësi e sidomos pjesëmarrja e saj në frontin e luftës për çlirim kombëtar, emancipim, pavarësi e barazi nacionale deri në vitet e fundit, ishte shumëdimensionale dhe gjithëpërfshirëse. Nga kjo del se numri i grave që morën pjesë në këtë luftë shumëshekullore ishte i madh. Kosova mburret me Shotë Galicën, Marie Shllakun, Xhevë Lladrovcin, Hanumshahe Avdullahun, por Kosova kishte edhe shumë heroína të tjera që në ndonjë punim tjetër do të mundem t'i përmendi. Gruas shqiptare asnjëherë dhe në asnjë periudhë nuk i ka munguar atdhetarizmi dhe vetëdija e lartë e saj se atdheu i saj ishte i robëruar. Kontributi i gruas shqiptare në luftërat shekullore për çlirimin e atdheut nga robëruesit nuk mund të vlerësohet vetëm nga shkalla e

¹ Krah për krah me burrat, Kosovarja e Re, nr. 1. 1982, f. 2.

² Sevëme Fetiçi, Gratë janë shtylla të një kombi e jo dekor për standard, 15 mars, 2014, Tubim me gratë në Heidelberg, Manifestim për nder të 8 Marsit, në organizimin e përbashkët të tri shoqatave, që veprojnë dhe punojnë në Heidelberg dhe atë të shoqatave të gruas “Nënë Tereza”, “Nermin Vlora-Falasci” si dhe Shoqatës Kulturore “Iliria”.

pjesëmarrjes së saj të drejtpërdrejtë në luftëra³. Gratë shqiptare kanë dëshmuar besnikërinë dhe shpirtin e tyre të madh, duke u bërë burim i forcës dhe qëndresës së të dashurve të tyre.⁴ Pikërisht, më 5 mars u bënë 20 vjet të rënies së komandantit legjendar, Adem Jasharit, familjes së tij dhe Jasharajve të tjerë. Mirëpo, çdo përvjetor Adem Jasharin e bënë më të lavdishëm⁵ historia e kombit tonë.

Studimi i qëndresës së grave të familjes Jashari përvës që është emocion dhe krenari, për studiuesit paraqet një fenomen historik, i cili duhet të prezantohet me gjithë dimensionin e vetë shkencor. Nga ne studiuesit kërkohet që ta qartësojmë sa më shumë kornizën e identifikimit të qëndresës së grave të familjes Jashari, dhe pastaj, duke e pasur të njohur dhe të zbërthyer brendësinë e saj, që domethënë formën themelore të saj, të krijohen mundësi reale që të thellohemi detajisht në substancë: padyshim, nga pikëpamja më e thelluar studimore-shkencore. Ekuivalent me qëllimin (objektivin), mund të konstatojmë se ngjarja e Prekazit, është një nga ngjarjet epokale të luftës çlirimtare, e cila si rrallë ndonjë tjetër, e shpalos idealin e lirisë. Kjo ngjarje, po ashtu, e shpalos vetëdijen dhe shpirtin sakrificues kundrejt ruajtjes së identitetit, të kulturës, të racës, me një fjalë, e shpalos gamën e ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit⁶tonë kombëtar. Ngjarja e Prekazit, po ashtu, si rrallë në historinë tonë, e shpalos tipologjinë e shqiptarit atdhetar, e shpalos modelin funksional të

³ Sabile Keçmezi-Basha, Kosova, vështrim historiko-politik, 1945-1990, Prishtinë, 2017, f. 369.

⁴ Agim Sylejmani, Në rrugë drejt lirisë (Intervistë me veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare, Mehmet Hajrizi, Prishtinë, Nëntor 2016, f. 189-190.

⁵ Bardh Hamzaj dhe Faik Hoti, Jasharajt (Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarata, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari), Prishtinë, 2003.

⁶ Fehmi Ajvazi, *Kush ishte Adem Jashari (studim në dorëshkrim)*, f. 103.

familjes shqiptare, e cila, pati gjithmonë një rol vendimtar në ruajtjen e substancës kombëtare kundrejt padrejtësive politike, historike, kundrejt okupimit, asimilimit dhe zhdukjes fizike të tij.

Gjithashtu, duhet thënë se lufta e Prekazit, si rrallë ndonjë ngjarje tjetër në historinë kombëtare dhe në historinë njerëzore, e shpalosi sakrificën heroike e legjendare të gruas shqiptare. Pra, kjo luftë e zhvilluar në fund të shekullit XX, e nxori në sipërfaqe një model të betejës unike nga domeni i luftës për liri. Por, ajo që është esenciale këtu, është fakti se kjo ngjarje, e nxori në sipërfaqe, nën një: gruan në luftën e drejtpërdrejtë, e cila jo vetëm që është unike në tërësinë e saj, porse, është qëndresë heroike e cila nuk ka përngjasim dhe as krahasim në historinë tonë nacionale, dhe në historinë njerëzore.⁷ Dhe dy: që të mos rrijë duarkryq para sulmeve barbare dhe okupuesve shekullor, gruan e Jasharajve e shtynin në radhë të parë: traditat e lashta në luftë për lirinë e vendit; të kultit për nderin e familjes; të shpirtit të lartë të vetësakrificës.⁸ Ndjenja e sakrificës për gruan e Jasharajve shpesh gjeti shprehje në më shumë se tri raste kundër sulmeve të egra serbe që ndodhën në familjen e tyre në Prekazin legjendar. Për gruan e Jasharajve okupimi klasik nga Serbia ishte edhe kulmi i fatkeqësisë, sepse ato ishin të vetëdijshme se së bashku me lirinë e atdheut do të humbnin edhe më të dashurit e tyre.

Që nga viti 1991 deri më 1998, Prekazi dhe Drenica përcilleshin nga spiunët dhe nga forcat paramilitare serbe. Synimi ishte vrasja e komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari

⁷ Fehmi Ajvazi, *Po aty*, f. 175.

⁸ Sabile Keçmezi-Basha, *Kontributi atdhetar i Hyrije Hanës*, Prishtinë, 2011, f. 19-20; Mediha Shuteriqi, *Gruaja shqiptare në luftë për çlirim kombëtar*, (Simpoziumi për Skënderbeun, 9-12 maj 1968), Prishtinë 1969, f. 405-406.

dhe familjes së tij, për të shuar dhe shtypur rezistencën që familja Jashari me në krye Ademin e Hamzën po ia bënin regjimit të Slllobodan Millosheviqit. Ngjarjet dramatike, të hapëta, kundër familjes Jashari kishin filluar më datën 30 dhjetor të vitit 1991, familja e Jasharajve rrethohet nga forcat policore dhe ushtarake serbe. Tre vëllezërit Jashari: Ademi, Rifati dhe Hamza, nuk pranuan t'u dorëzoheshin kriminelëve serbë, por iu kundërpërgjigjën me zjarr, duke çarë rrethimin, ku lanë dhjetëra ushtarë dhe policë serbë të plagosur. Në këtë ngjarje u plagos nga helikopteri serb, Vesel Selimi nga Açareva.⁹

Rrethimi i dytë i familjes Jashari u bë, më 22 janar të vitit 1998. Forcat serbe sulmuan familjen Jashari, por edhe kësaj beteje, gratë dhe fëmijët e familjes Jasharaj i rezistuan. Megjithatë, në këtë betejë që zgjati afër 30 minuta, të plagosura mbeten Iliriana, vajza e Rifat Jasharit dhe Selvetja, vajza e Hamzë Jasharit, që ishin në mbështetje të luftëtarëve të Jasharajve. Bashkëfshatarët duke e parë se cak i sulmit serb, ishin familja Jashari, ata kërkuan nga i zoti i shtëpisë së Jasharajve që t'i tërheqin gratë dhe fëmijët nga aty. Por, edhe gratë, edhe fëmijët kishin marr vendimin që të qëndrojnë në shtëpi dhe të rezistojnë bashkë me të tjerët¹⁰. Qëndruan për t'i treguar botës se gratë e burrat e Jasharajve nuk shkojnë askund përtej truallit dhe shtëpive të tyre dhe do e mbrojnë vendin deri në pikën e fundit.

Po të njëjtin vit (1998), për tri ditë rresht, më 5, 6 dhe 7 mars, familja heroike me në krye komandantin legjendar Adem Jasharin, u bëri ballë sulmeve të pareshtura të makinerisë serbe. Familja Jashari

⁹www.alsat-m.tv/19-vjet-nga-beteja-e-jashareve, 3 prill 2017, Drenicë, 19 vjet nga beteja e Jasharajve, 9.02.2018

¹⁰www.kosovapress.com/sq/opinione/dilaver-goxhaj-189/adem-jashari...3 prill 2017-04-03, Historia e familjes Jashari, 06.02.2018.

këtë herë do të qëndronte për jetë a vdekje. Shpëtuan nga kjo betejë vetëm Besarta dhe Bashkimi. Ndërsa, nuk ndodheshin në shtëpi, bacë Rifati, Murati, Bekimi dhe Lulzimi që gjendeshin në emigracion, si dhe Iliriana, Shqipja, Marigona dhe Fazliu, të cilët një ditë më parë kishin shkuar në Okrashticë.¹¹ Adem Jashari me familjen para se të vriteshin i kishin dhënë besën njëri-tjetrit se, të gjithë do të luftonin deri në vdekje për çlirimin e vendit. Para se të vritej Adem Jashari kishte deklaruar: “Nuk do të dorëzohem për së gjalli, vrastarët nuk do të kalojnë veçse mbi trupin tim të vdekur”.

Në luftën kundër serbëve, në mars të vitit 1998 në kullat e Jasharajve legjendar u vranë 48 veta, e nga familja e ngushtë e Adem Jasharit, në mars të vitit 1998, janë vranë 20 veta, prej të cilave, 12 gra e vajza (midis tyre 3 të mitura), që me këtë rast do i përmendi vetëm emrat e gjinisë femërore që u vranë në këtë luftë: si Zahide Geci-Jashari (74-vjeçare), nëna e Ademit; Zarife Jashari (49-vjeçare) gruaja e Rifatit; Hidajete Rifat Jashari (18), vajza e Rifatit; Valdete Rifat Jashari (15), vajza e Rifatit; Igballe Rifat Jashari (11), vajza e Rifatit; Feride Mecini-Jashari (43), gruaja e Hamëz Jasharit; Selvete Hamëz Jashari (20), vajza e Hamëz Jasharit; Afete Hamëz Jashari (17), vajza e Hamëz Jasharit; Lirie Hamëz Jashari (15), vajza e Hamëz Jasharit; Fatime Hamëz Jashari (9), vajza e Hamëz Jasharit; Blerinë Hamëz Jashari (7), vajza e Hamëz Jasharit; Adile Rama-Jashari (40)¹², gruaja e Adem Jasharit, e cila ishte vra e para me rastin e sulmit, rrëfen Besarta Jashari, e shpëtuar e sulmit, e cila tregon se “Adilja, gruaja e Ademit, ajo u vra

¹¹ Rrëfimet e Besarta dhe Bashkim Jasharit... Bardh Hamzaj dhe Faik Hoti, Jasharët (Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarata, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari), Prishtinë, 2003, 94-95.

¹² Zenepe Dibra, Fjalor enciklopedik i gruas shqiptare, Shkodër, 2009, f. 193-194.

në shkallët e njërës shtëpi. Ajo shkoi me marrë municion në katin e tretë të shtëpisë ku i kishin dhomat bali Adem dhe babai ynë, Hamza”.¹³ Sulmi mbi familjen Jashari, nuk u bë vetëm pse ishte shqiptare, por pse pjesëtarët e saj ishin luftëtarë, pse ishin bërthama e UÇK-së, pse ishin shembulli i familjes liridashëse, pse Serbisë i kishin shkaktuar humbje dhe kërkonte të hakmerrej mbi një familje për të përhapur tmerr e frikë në çdo vatër shqiptare. Sulmi në familjen Jashari nuk kishte vetëm qëllimin e zhdukjes së një familje shqiptare dhe vrasjen e komandantit të UÇK-së, por qëllim kryesor kishte vrasjen e guximit të shqiptarëve për të luftuar për çlirim e bashkim kombëtar.

Në kohën kur në trojet shqiptare arsimit shqip u detyrua që të zhvillohej jashtë sistemit edukativo-arsimor, roli edukues i ambientit familjar dhe në mënyrë të veçantë i nënës dhe i gjyshes për fëmijën ishte vendimtar. Burrat trima lindin dhe rriten vetëm nga nëna trimëresha, thotë një fjalë e popullit. Gruaja shqiptare e ka përbuzur kurdoherë frikacakun, ajo e ka përbuzur dhe e ka mallkuar edhe birin e saj kur plogështojë përpara vdekjes.¹⁴

E tillë ishte shkolla e edukimit atdhetar në familjen Jashari të Prekazit të Drenicës, të cilën e bënë gratë e Jasharajve. Një shkollë që do të mbahet mend brez pas brezi dhe përjetësisht... Këtij sulmi i mbijetoi vetëm Bashkimi, djali i Rifatit, i cili ia del që mes datës 5-6 mars të largohet nga rrethina dhe arrin t’i shpëtojë sulmit,¹⁵si dhe në

¹³ Rrëfimet e Besarta dhe Bashkim Jasharit... Bardh Hamzaj dhe Faik Hoti, Jasharajt (Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarata, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari), Prishtinë, 2003, f. 92.

¹⁴ Sabile Keçmezi-Basha, “Gruaja shqiptare në shërbim të çështjes kombëtare” (fejton 5 vazhdime), “Bujku” 24-28 janar 1996.

¹⁵ www.albaniapress.com/lajme/15991/Adem-Jashari-lufta-dhe-rendesia-e..., 12.02.2018.

këtë betejë legjendare-mitike, shpëtoi gjallë edhe një vajzë e vogël me shpirt engjëlli, dhe me një emër të bukur e sinjifikativ për kohën dhe për vendin: Besarta! Kjo vajzë e Hamzës,¹⁶ shpëtoi e gjallë, se kjo duhej të shpëtonte për dy arsye: a) *Për të qenë dëshmitare e kësaj ngjarje legjendare-mitike*; b) *Për të qenë dëshmitare e misionit dhe e sakrificës së lirisë*.¹⁷

Ajo që do të ndodhë në fillimet e marsit të vitit 1998 do të jetë një dëshmi e gjallë për botën e qytetëruar dhe përgjegjësit e saj politikë e diplomatikë. Në të vërtetë kjo ngjarje kaq e drejtpërdrejtë dhe kaq e fuqishme për nga përmasat e saj të flijimit unikat, të qëndresës e të masakrimit do ta ngrejë çështjen e Kosovës në krye të agjendës botërore.¹⁸ Me aktin e rënies së komandantit legjendar Adem Jasharit, familjes së tij dhe Jasharajve të tjerë, Kosova mundi frikën me çka i hapi shtigjet e lirisë dhe të ardhmërisë. Familja Jashari (pjesa më e madhe e familjarëve u vranë), për të dhënë kumtin që iluzioni mori fund, që realiteti kosovar nuk mund të durojë Serbinë dhe shqiptarët në një vend, në Kosovë.¹⁹ Familja Jashari i dha identitet realitetit të njëmend të Kosovës. I dha emër çlirimit të saj në muajt dhe vitet e mëvonshme.

Qëndresa e pa epur e grave të Jasharajve ishin frymëzim për të gjitha gratë shqiptare në vitet e mëvonshme dhe tani. Ato vërtetë

¹⁶ Bardh Hamzaj dhe Faik Hoti, Jasharët (Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarata, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari), Prishtinë, 2003, f. 91-95.

¹⁷ Fehmi Ajvazi, Vepër e cituar, f. 163.

¹⁸ pashtriku.beepworld.de/.../dilavergoxhaj_ademjashariiii_2.12.07.htm, Adem Jashari i tha popullit : Mos dëgjo moral nga imoralët dhe, mos beso të pabesët!

¹⁹ Blerim Shala, Njeriu që diti sa vlen liria e Kosovës, Bardh Hamzaj dhe Faik Hoti, Jasharët (Historia e rrëfyer nga Rifat, Besarata, Bashkim, Murat dhe Lulzim Jashari), Prishtinë, 2003, f. 107.

punonin në shtëpi, por zinin një vend të nderuar në familje²⁰ dhe se jeta e grave të Jasharajve fisnikërohej me të qenit nënë. Është e vërtetë se ato vlerësonin shumë lartë të qenit nënë dhe bashkëshorte. Gjithë jeta e tyre ndërtohej në këto dy shtylla kryesore, por kur e kërkoi atdheu e familja, ato dëshmuuan se që të dyja i sakrifikuan për liri, gjë që u ngritën në pedestalin e barazisë me heronjtë.

Roli dhe ndikimi i sakrificës në Prekaz, ka dimension gjithëpërfshirës, si brenda vendit, po ashtu, edhe jashtë vendit! Ajo, është një prej ngjarjeve që me mënyrën apo me sistemin e zhvillimit, ka habitur dhe ka shtangur jo vetëm shqiptarët, por këdo që ka dëgjuar për të. Pësha, efekti dhe ndikimi i saj lëvizti aso kohe gjithçka: si në lindje po ashtu edhe në perëndim. Dhe jo rastësisht, duhet thënë se familja Jashari, pati rol polidimensional brenda një kauze të drejtë kombëtare, fillimisht mbi kondita politike, e më pastaj, edhe mbi kondita të tjera siç qe, kauza e ndritshme e organizimit dhe e fillimit të rezistencës së armatosur.²¹

Për qëndresën e familjes Jashari u shkrua në shumë shkrime shkencore e publicistike dhe jo vetëm në ato. Por, ajo që më bëri përshtypje është shkrimi i motrës së dëshmorit, Afrim Zhitia, Sadete Zhitia, e cila për rolin politik, atdhetar, sakrifikues të kësaj familjeje, ja se çfarë shkruan: *“Vetëm një familje e tillë emblemë, ku mbizotëronte harmonia dhe dashuria e pafund, mund të jap mesazhin e fuqishëm. Vetëm një familje me një edukatë të mirëfilltë njerëzore, intelektuale e patriotike mund t’i jap popullit të saj mundësinë që ta përjetësoj legjendën dhe mitin, pa pasur nevojë të kalojnë vitet. Vetëm një familje*

²⁰ Sabile Keçmezi-Basha, “Heroizmi i gruas shqiptare parë nga të huajt”, Epoka e Re, 3 gusht 2015.

²¹ Fehmi Ajvazi, Kush ishte Adem Jashari (studim në dorëshkrim), f. 175.

e ngritur e me edukim të shëndoshë, ka mundur t'i dhurojë popullit të vetë, rastin unik dhe të papërsëritshëm në historinë e luftërave për liri. Janë të panumërta rastet kur heronjtë dhe dëshmorët kanë dhënë jetën për atdhe, por sakrifica që e bënë Jasharajt është unike. Ata, luftuan bashkë me fëmijët e tyre. E pikërisht ky fakt, e bënë edhe më madhështore dhe mbinjerëzore sakrificën e kësaj familje".²²

Dhe krejt në fund, më lejoni që t'i numëroi disa tipare të jashtëzakonshme-sublime për gratë e Jasharajve: a) *Gratë e Jasharajve në bazë të qëndresës që bënë, mishërojnë rolin historik kombëtar dhe jo vetëm kombëtar në gamën e identitetit, të zhvillimit dhe të kontributit patriotik liridashës.* b) *Gratë e Jasharajve, në mënyrë të vetëdijshme mobilizohen dhe organizohen përkrahë burrave që aspiratat për liri, t'i realizojë deri në shkallë sublime.* c) *Gratë e Jasharajve, me kontributin dhe me aktivitetin e pakursyer të tyre, përmes rezistencës dhe sakrificës sublime, bëhen shembull i veçantë i organizimit dhe i bashkimit, një atribut që na kishte munguar vazhdimisht në historinë tonë të luftës për liri.* ç) *Gratë e Jasharajve, me mënyrën e rezistencës dhe të sakrificës, e thyen përfundimisht mitin e forcës apo të epërsisë së pushtuesit, kundrejt të pushtuarit.* d) *Gratë e Jasharajve, janë rasti i vetëm në histori i mënyrës së organizimit dhe sakrificës së përbashkët, dhe si e këtillë, mund të konsiderohet edhe si një fenomen Kombëtar i rezistencës në luftën për liri.*

²² Sadete Zhitia, Jasharajt - Madhështia e një qëndrese kombëtare, Analizë. 07. 03. 2008.

